



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, 24 dhe 40 të Ligjit, Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 27, 28 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 dhe në zbatim të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-16-586, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren për ndryshim plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 01-Nr-110-47552, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet kërkesa 01-Nr-553-27510 e datës 13.05.2025 e parashtruar nga Lirim Rudaj nga fshati Savrovë, Komuna e Suharekës, për ti ndihmuar në renovimin e shtëpisë, pasi që me datën 12.05.2025, i është djegur shtëpi. I ndahen mjete financiare në shumë prej: **5,000.00€ (pesë mijë euro)**.

Neni 2

2.1 Mjetet financiare do të paguhen nga buxheti i Komunës së Suharekës të planifikuara në vitin 2025, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, kodi i programit 21/624/16012/22202/00000/0111 të planifikuar në Zyrën e Kryetarit (pagesa për transferet për përfitues individual të tjera).

2.2 Mjetet financiare do të lëshohen në xhirollogarinë e përfitues.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës në bashkëpunim me Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI